



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), nenin 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, më datë 06.02.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z. Faton Berisha**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Klinë, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal **z. Shemsi Bajraktari**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Faton Berisha dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 05.02.2026 me numër të protokollit 07/7-204/2026, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal, i cili ka dhënë dorëheqje, për arsye të zgjedhjes në pozitë tjetër. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është Faton Berisha. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke ruajtur kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 06.02.2026

Kreshnik RADOMIQI

Kryesues i KQZ